



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.22/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 27.11.2024 të parashtruar nga ankesja M. D. nga Gjilani, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, më datë 03.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankesja M. D. nga Gjilani, e datës 27.11.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 27.11.2024, ankesja M. D. ka paraqitur parashtrësë drejtuar kryetarit të gjykatës, duke theksuar se në këtë gjykatë është zhvilluar procedura civile sipas lëndës C.nr.1717/2020, e iniciuar me padinë e paditës 03.08.2020, duke shtjelluar paditësit, të paditurit dhe objektin e kontestit. Ka sqaruar se fillimisht lënda ka qenë e ndarë tek gjyqtari B. B., ku janë ndërmarrë veprimet e shqyrtimit paraprak të padisë, mirëpo për 4 vite rradhazi nuk është caktuar asnjë seanca gjyqësore, me ç’rast kanë ndërruar rrethanat e palëve në proces për shkak të vdekjes së të palëve kontraktuese. Më tej, gjatë vitit 2022 inicohet një padi tjetër nga paditësit e cila merr numrin e lëndës C.nr.1409/2022 dhe propozohet caktimi i masës së përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë. Të dy këto lëndë kanë qenë të caktuara te gjyqtari B. B., i cili transferohet në degën e Vitisë dhe të njëjtat lëndë i ndahen gjyqtares M. A., e cila cakton seancë për shqyrtimin përgatitor dhe tenton t’i bashkojë lëndët. Palët kundërshtojnë bashkimin e lëndëve, ndërsa gjyqtarja shtyn seancën dhe thotë “se unë dashta me ju bë mirë, faji është i imi, penalizomni”. Në seancën e rradhës, gjyqtarja revokon aktvendimin për dëgjimin e dëshmitarëve, duke konsideruar se ka prova të mjaftueshme për këtë lëndë, po ashtu revokon aktvendimin për dëgjimin e palëve dhe përfundon seancën pa e administruar fare provën e dorëzuar nga paditësit – cd. Edhe në seancën tjetër refuzon që të dëgjohen paditësit dhe më datë 30.09.2024 ka marrë aktgjykim me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazë. Më tej ka shtjelluar edhe njëherë objektin e kontestit dhe interesin e palëve në proces, ndërsa ka konsideruar se gjyqtarja e çështjes nuk i ka marrë parasysh fare veprimet procedurale të paditësve. Të

pakënaqur me këtë vendim, paditësit kanë ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, mirëpo ka konsideruar se përmes këtij vendimi të njëjtëve nuk i është ofruar mbrojtja gjyqësore, e përkundrazi i janë krijuar probleme të mëtejme. Nga kryetari i gjykatës ka kërkuar që të ndërmer veprime të nevojshme konform autorizimeve ligjore.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankueses nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, pasi në rastin konkret të njëjtat janë në tërësi pretendime ankimore dhe paditësit veçse kanë ushtruar ankesë ndaj vendimit, i cili vendim i nënshtrohet shqyrtimit të ligjshmërisë nga gjykata e shkallës së dytë. Për këtë arsye diferencohet shkallshmëria e vendimeve deri në instancën e tretë nga veprimet që përbëjnë shkelje disiplinore, pasi nga pretendimet e ankueses, veprimet e gjyqtarës konsistojnë vetëm në ndërmarrjen e vendimit meritore për këtë çështje kontestuese.

Kryetari i gjykatës vlerëson se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari bazohet në shkeljet disiplinore të cilat janë të rradhitura taksativisht në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e nuk kanë të bëjnë me mënyrën e vendosjes së gjyqtarës së çështjes, e gjithashtu pretendimet e ankueses nuk bien ndesh as me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Ankuesja në anën tjetër ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, e në rastin konkret pretendimet e të njëjtës janë të orientuara në këtë drejtim dhe nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtrueses M. D. nga Gjilani, e datës 27.11.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. Gjyqtarës M. A.
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.